



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 95/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkizati për ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të ndërrimit të Qendrës së Votimit (QV) disa votuesve, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si te pabazuara ankesat Anr.95/2012 dhe Anr. 96/2012 të datës 29.04.2012 të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

A r s y e t i m

PZAP, më datë 29.04.2010, ka pranuar ankesën Anr. 95/2012, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se familja e kryetarit të nëndegës së 5 të subjektit politik LDK, Bejtush Malqi prej 16 anëtarësh janë hequr nga vendvotimi në shkollën fillore “Jeronim De Rada” në Ferizaj ku kanë votuar gjithnjë dhe janë dërguar në një shkollë tjeter.

PZAP, më datë 29.04.2010, ka pranuar ankesën Anr. 96/2012, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se ne këto zgjedhjeve shumë votues të cilët më parë kanë votuar në një vendvotim, gjatë këtyre zgjedhjeve u janë ndërruar vendvotimet. Kjo gjë, sipas parashtruesit të ankesës, është një dukuri e shpeshtë dhe është bërë me qëllim për ti dekurajuar votuesit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmblushin standartet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, nen 3 paragrafi 6 pikë (c) parasheh:

- (c) *hollësi rrëth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, nen 6 paragrafi 3 parasheh:

6.3 “*Me qellim te lehtësimit te shqyrimit te ankesave, kryesuesi i panelit mund te vendose ta bëj bashkimin e ankesave qe përbajnjë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato si kur të ishin një ankesë*”.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesat janë të pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesave, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkaku se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për tu vërtetuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë, pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë që do ta argumentonin se ju është bërë ndërrimi i Qendrave të Votimit (QV) personave në fjalë, si dhe nga pretendimet ankimore në fjalë nuk rezulton se personave në fjalë ju është mohuar e drejta për të votuar ashtu siç e parasheh nen 5 i LZP-së, prandaj në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

A nr. 95/2012 më datën 30.04.2012.

Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha



Prishtinë / Pristina

Lloji i Panelit Zgjedhor për Ankesa

Paneli Zgjedhor për Ankesa

Lloji i Panelit Zgjedhor për Ankesa